



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7236 Prot.

Roskovec, më 28, 08, 2025

VENDIM

NR. 46 DATË 28, 08, 2025

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026 – 2028”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma “k” i ndryshuar, të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026 – 2028 të Bashkisë Roskovec, sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës si dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka






BASHKIA ROSKOVEC



Plani i Arsimit Parauniversitar 2026 - 2028




Parathënie.....	5
1. Hyrje dhe konteksti	7
Profili demografik dhe social i Bashkisë (Census 2023):.....	7
Kudri ligjor që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor.....	9
2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor.....	10
Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Roskovec.....	10
Infrastruktura dhe aksesueshmëria	10
Kapaciteti dhe organizimi i shërbimit	10
Gjendja e infrastrukturës dhe siguria	10
Shërbimet bazë	11
Mjete didaktike dhe shërbimi ushqimor.....	11
Frekuentimi dhe përfshirja sociale	11
Stafi dhe burimet njerëzore	11
Strukturat menaxheriale	11
Gjetje dhe rekomandime	11
Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë administrative Kurjan	12
Infrastruktura dhe aksesueshmëria	12
Kapaciteti dhe organizimi	12
Pajisjet dhe kushtet sanitare	12
Shërbimet bazë	12
Mjete didaktike dhe ushqimi	12
Frekuentimi dhe përfshirja	13
Stafi dhe burimet njerëzore	13
Strukturat menaxheriale	13
Gjetje dhe rekomandime	13
Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë administrative Strum.....	13
Infrastruktura dhe aksesueshmëria	13
Kapaciteti dhe organizimi	13
Pajisjet dhe kushtet sanitare	14
Shërbimet bazë	14
Mjete didaktike dhe ushqimi	14
Frekuentimi dhe përfshirja	14
Burimet njerëzore	14
Strukturat menaxheriale	15



Gjetje dhe rekomandime:	15
Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Kuman	15
Infrastruktura dhe aksesueshmëria	15
Kapaciteti dhe organizimi	15
Gjendja e ndërtesave dhe siguria.....	16
Shërbimet bazë dhe ngrohja	16
Mjete didaktike dhe ushqimi	16
Frekuentimi dhe përfshirja	16
Burimet njerëzore	16
Strukturat menaxheriale	16
Gjetje dhe rekomandime:	16
Të dhënat për burimet financiare për shërbimin e arsimit parashkollor – Kopshtet 2023 - 2025.....	17
Prioritetet strategjike për arsimin parashkollor	17
Burimet financiare të disponueshme.....	17
Nevojat prioritare për investime (2026–2028).....	17
3. Analiza e shërbimit në shkolla	17
Njësia Administrative: Roskovec	17
Gjendja Infrastrukturore dhe nevojat për investim	18
Shërbimet themelore dhe higjiena.....	18
Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike.....	19
Transporti i nxënësve	19
Përfshirja sociale dhe mbështetja psiko-sociale	19
Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale	19
Gjetje dhe rekomandime	19
Njësia Administrative: Kuman	19
Gjendja Infrastrukturore dhe nevojat për Investim	20
Shërbimet themelore dhe higjiena.....	20
Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike.....	20
Transporti i nxënësve	20
Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale	20
Gjetje dhe rekomandime	20
Njësia Administrative: Kurjan	21
Gjendja Infrastrukturore dhe nevojat për investime.....	21
Shërbimet themelore dhe higjiena.....	21
Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike.....	21

Transporti i nxënësve	22
Përfshirja sociale dhe barazia në arsim	22
Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale	22
Gjetje dhe rekomandime	22
Njësia Administrative: Strum	22
Gjendja infrastrukturore dhe nevojat për investim.....	23
Shërbimet themelore dhe higjiena.....	23
Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike.....	23
Transporti i nxënësve	23
Përfshirja sociale dhe mbështetja psiko-sociale	24
Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale	24
Gjetje dhe rekomandime	24
4. Prioritetet strategjike të bashkisë për Arsimin (Shkollat)	25
5. Nevojat prioritare për investime në shkolla (2026–2028).....	25
6. Vizioni dhe objektivat strategjike	25
7. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve).....	26
8. Buxheti i planifikuar për Arsimin (2026–2028).....	32
Burimet financiare të disponueshme.....	32
Shërbimet operative dhe mirëmbajtja Arsimit parashkollor	33
Shpenzimet operative për arsimin – shkollat (2026–2028)	34
9. Plani i investimeve kapitale.....	35
10. Monitorimi dhe vlerësimi	36
Indikatorët e Performancës	36
Planifikimi i vlerësimit të progresit	36
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	36
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi	36
11. Rishikimi dhe përshtatja e planit	37
12. Raportimi dhe transparenca	38
13. Aneksë:	39
Kadri Ligjor dhe Nënligjor për Arsimin Parauniversitar	39



Parathënie



Arsimi është themeli i zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirës të çdo komuniteti. Bashkia Roskovec e ka vendosur atë në qendër të prioritetëve të veta strategjike, si një e drejtë e patjetërsueshme e çdo fëmije dhe si një mjet i fuqishëm për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për qytetarët tanë.

Ky Plan për zhvillimin e Arsimit Parauniversitar është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës analizash, konsultimesh dhe reflektimesh mbi realitetin arsimor lokal dhe aspiratat tona si bashki. Ai përfaqëson një angazhim të qartë institucional për të garantuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe cilësor, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar – nga çerdhet e deri tek arsimi i mesëm.

Në këtë plan, janë përcaktuar vizioni ynë i përbashkët, objektivat strategjike, masat konkrete, si dhe mekanizmat për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor lokal. Ne jemi të vendosur të investojmë jo vetëm në infrastrukturë, por edhe në cilësinë e mësimdhënies, përfshirjen sociale, zhvillimin profesional të stafit dhe krijimin e mjediseve arsimore që frymëzojnë rritje dhe zhvillim të gjithanshëm për çdo fëmijë.

Të udhëhequr nga vizioni për një sistem arsimor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe cilësor, ne angazhohemi që përmes këtij plani të ndëtojmë një realitet arsimor ku çdo fëmijë në Bashkinë Roskovec të ketë mundësinë të rritet, të mësojë dhe të lulëzojë.

Majlinda Bufi

Kryetare e Bashkisë Roskovec



Falënderime

Bashkia Roskovec shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Roskovecit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Roskovec.



1. Hyrje dhe konteksti

Profili demografik dhe social i Bashkisë (Census 2023):

Bashkia Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Mallakastër, në lindje me bashkinë Ura Vajgurore, ndërsa në perëndim me bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit.

Bashkia e Roskovecit ka një sipërfaqe prej 118.01 km². Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 14 fshatra.

Tabela paraqet popullsinë banuese sipas Censit 2023, gjinisë dhe grupmoshat kryesore.


Bashkia	Gjithsej				Meshkuj	Femra
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	Gjithsej
Roskovec	16,332	2,526	10,504	3,302	8,313	8,019

Sipas Censit të vitit 2023, Bashkia Roskovec numëron 16,332 banorë, të shpërndarë në mënyrë të baraspeshuar mes gjinive:

- Meshkuj: 8,313
- Femra: 8,019

 **Struktura e popullsisë sipas grupmoshave dhe njësive administrative:**

Grupi Moshor	Popullsia	Përqindja në total
0–14 vjeç	2,526	15 %
15–64 vjeç	10,504	64%
65+ vjeç	3,302	20%
Gjithsej	16,332	100 %




- Popullsia në moshë pune (15–64 vjeç) përbën shumicën dërrmuese, me rreth 64 % të totalit – një tregues i potencialit për zhvillim ekonomik dhe përfshirje në punësim.
- Të miturit (0–14 vjeç) përfaqësojnë 15 % të popullsisë – një tregues i nevojës për investime në edukim dhe shërbime për fëmijë.
- Mosha e tretë (65+) përbën 20 %, që sinjalizon një tendencë të plakjes së popullsisë dhe nevojën për kujdes afatgjatë dhe politika sociale mbështetëse.
- Raporti gjinor është praktikisht i balancuar: 51% meshkuj, 49 % femra.

Aktualisht, Bashkia Roskovec përfshin gjithsej 4 njësi administrative: Roskovec, Kuman, Kurjan, Strum të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Tabela 1 Popullsia banuese sipas njësive administrative, gjinisë, viti 2023¹

Njësia administrative		Popullsia banuese
		2023
BASHKIA ROSKOVEC	Gjithsej	16.332
	Meshkuj	8.313
	Femra	8.019
Kuman	Gjithsej	4.154
	Meshkuj	2.118
	Femra	2.036
Kurjan	Gjithsej	2.416
	Meshkuj	1.241
	Femra	1.175
Roskovec	Gjithsej	4.078
	Meshkuj	2.034
	Femra	2.044
Strum	Gjithsej	5.684
	Meshkuj	2.920
	Femra	2.764



Bashkia Roskovec paraqet një profil demografik me popullsi relativisht të qëndrueshme në numër, por e karakterizuar nga disa tendenca shqetësuese sociale dhe strukturore. Konkretisht, vihet re një plakje e theksuar e popullsisë, një ulje e vazhdueshme e lindshmërisë, si dhe një nevojë në rritje për ndërthurjen e zhvillimit ekonomik me zgjerimin e shërbimeve sociale.

Këto karakteristika e vendosin arsimin parauniversitar përballë sfidave të veçanta në planifikim dhe zbatim, veçanërisht në drejtim të sigurimit të aksesit të barabartë në arsim, menaxhimit të distancave gjeografike midis zonave të banuara, përmirësimit të infrastrukturës shkollore, si dhe garantimit të përfshirjes së grupeve më të cenuara, përfshirë fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që përballen me rreziqe sociale.

¹ Instat, Census 2023

Ky kontekst kërkon një qasje të integruar dhe të kujdesshme në hartimin e politikave vendore arsimore, që të adresojë realisht nevojat dhe të maksimizojë mundësitë për zhvillim gjithëpërfshirës.

Kuadri ligjor që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Në Bashkinë e Roskovecit, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit parauniversitar mbështeten në kuadrin ligjor dhe politik kombëtar që rregullon funksionimin e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë. **Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, i ndryshuar, përcakton strukturën dhe përmbajtjen e arsimit në të gjitha nivelet – përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional – si dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për garantimin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim.

Përveç tij, **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** i ka ngarkuar njësitë të qeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë e Roskovecit, kompetenca të drejtpërdrejta në ofrimin e shërbimeve të arsimit parashkollor. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike në territorin e saj, përfshirë sigurimin e infrastrukturës, furnizimeve dhe stafit ndihmës. Për arsimin bazë dhe të mesëm, edhe pse kompetencat kryesore i përkasin Ministrisë së Arsimit dhe strukturave të saj vendore, Bashkia ka një rol të rëndësishëm mbështetës, veçanërisht në menaxhimin e infrastrukturës, mbështetjen e transportit të nxënësve, aksesit për fëmijët me nevoja të veçanta dhe sigurisë në institucionet arsimore.

Në zbatim të këtyre detyrimeve, Bashkia Roskovec harton dhe zbaton politika vendore për arsimin, të cilat janë të orientuara nga prioritetet kombëtare dhe nevojat lokale. Këto politika janë të integruara në dokumente strategjike si **Plani i Përgjithshëm Vendor**, si dhe dokumente specifike për sektorin e arsimit, ku pasqyrohen nevojat infrastrukturore, numri dhe shpërndarja e fëmijëve në territor, burimet njerëzore, përfshirja e grupeve vulnerabël dhe bashkëpunimi me komunitetin e prindërve dhe partnerë të tjerë.

Gjithashtu, Bashkia e Roskovecit bashkëpunon ngushtësisht me **Zyrën Vendore Arsimore** dhe institucionet arsimore publike për të garantuar koordinimin institucional në zbatimin e politikave dhe standardeve arsimore, përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për nxënësit. Ky bashkëpunim mundëson ndërhyrje të përbashkëta në rastet që lidhen me rikonstruksionin e objekteve shkollore, menaxhimin e emergjencave, regjistrimet në institucione arsimore dhe përfshirjen e fëmijëve që rrezikojnë të mbeten jashtë sistemit arsimor.

Në këtë mënyrë, Bashkia e Roskovecit vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore në territorin e saj, duke kontribuar në sigurimin e një arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në territor.



2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor

Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Roskovec

(Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Në territorin e Njësisë Administrative Roskovec funksionojnë dy institucione të arsimit parashkollor publik: Kopshti Nr.1 Roskovec dhe Kopshti “Lulet e Jetës”. Të dy institucionet ndodhen në zonën urbane të qytetit Roskovec dhe shërbejnë si hallka kyçe për sigurimin e edukimit të hershëm për fëmijët e grupmoshës 3–6 vjeç. Ato jo vetëm që plotësojnë nevojat arsimore të kësaj kategorie, por ofrojnë gjithashtu mbështetje në aspektin social dhe familjar, përmes përfshirjes së strukturave bashkëpunuese me komunitetin.

Infrastruktura dhe aksesueshmëria

Të dy institucionet ndodhen brenda zonës së banuar dhe kanë akses të lehtë për këmbësorë dhe automjete. Rruga që të çon në secilin kopsht është e pajisur me trotuar, sinjalistikë rrugore dhe ndriçim publik, duke garantuar një qasje të sigurt për fëmijët dhe shoqëruesit e tyre. Transporti i fëmijëve realizohet në mënyrë private, dhe nuk ofrohet transport i organizuar nga institucionet apo bashkia.

Kapaciteti dhe organizimi i shërbimit

Kopshti Nr.1 Roskovec funksionon me dy klasa mësimore, të cilat presin një total prej 47 fëmijësh. Ata janë të organizuar në dy grupe: një grup i përzier për fëmijët 3 dhe 4 vjeç dhe një grup i dedikuar për fëmijët 5–6 vjeç. Përbërja gjinore është 21 vajza dhe 26 djem, me një shpërndarje të ekuilibruar sipas moshave:

- 3 vjeç – 9 fëmijë
- 4 vjeç – 24 fëmijë
- 5–6 vjeç – 14 fëmijë

Kopshti “Lulet e Jetës” ka kapacitet më të madh dhe shërben për 70 fëmijë, të ndarë në tre grupe të ndara sipas moshës:

- Grupi I (3 vjeç) – 27 fëmijë
- Grupi II (4 vjeç) – 25 fëmijë
- Grupi III (5–6 vjeç) – 18 fëmijë

Të dy institucionet janë të pajisura me infrastrukturë mbështetëse të përshtatshme për grupmoshat parashkollore. Në total, Kopshti Nr.1 ka 50 karrige dhe 13 tavolina, ndërsa “Lulet e Jetës” ka 72 karrige dhe 10 tavolina. Ambientet sanitare përbëhen nga 4 tualete dhe 4 lavamanë në Kopshtin Nr.1 dhe 8 tualete e 4 lavamanë në “Lulet e Jetës”.


Gjendja e infrastrukturës dhe siguria

Kopshti “Lulet e Jetës” operon në një ndërtesë dykatëshe me sipërfaqe totale 340 m², dhe ndonëse është funksional, ai ka nevojë për ndërhyrje në disa komponentë të infrastrukturës.

Problematikat më urgjente përfshijnë:

- Ndërhyrje në paisjet sanitare dhe hidraulike
- Lyerje e ambienteve të brendshme
- Mungesa e daljeve emergjente
- Mungesa e sistemit të alarmit

Nga ana tjetër, Kopshti Nr.1 është i pajisur me sistem alarmi funksional, por gjithashtu nuk ka dalje emergjente, çka përbën një pikë të dobët në garantimin e sigurisë së fëmijëve dhe stafit në raste emergjente.



Shërbimet bazë

Të dy institucionet kanë furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm, përmes ujësjellësit publik dhe depozitave ndihmëse. Ngrohja në të dy kopshtet realizohet me sistem elektrik, dhe energjia elektrike sigurohet nga rrjeti shtetëror. Në aspektin e komunikimit dhe teknologjisë, Kopshti “Lulet e Jetës” ka lidhje interneti, ndërsa Kopshti Nr.1 nuk ka. Asnjëri nga institucionet nuk disponon lidhje telefonike. Produktet bazë higjienike si letër, sapun dhe dezinfektues janë të siguruara dhe të përdorura rregullisht.

Mjete didaktike dhe shërbimi ushqimor

Të dy kopshtet janë të pajisura me mjete didaktike të mjaftueshme, të siguruara në bashkëpunim mes bashkisë, prindërve dhe mësuesve. Për përmirësimin dhe zgjerimin e mjeteve edukative në të gjithë territorin e bashkisë, është i nevojshëm planifikimi një financim prej 500.000 lekësh për 400 fëmijë.

Vetëm Kopshti “Lulet e Jetës” ofron shërbim ushqimi, i cili mbulon të gjithë fëmijët e regjistruar (70). Në funksion të këtij shërbimi, është identifikuar nevoja për blerje të pajisjeve të reja të kuzhinës, përfshirë sobë, mikser, pjata, gota, thika, mbulesa, peshqirë dhe çarçafë, me një vlerë të kërkuar prej 500,000 lekësh.

Frekuentimi dhe përfshirja sociale

Frekuentimi i fëmijëve në të dy kopshtet është i rregullt dhe i qëndrueshëm. Në Kopshtin Nr.1, nga 21 fëmijë të identifikuar në moshë parashkollore sipas vendbanimit, 2 nuk janë të regjistruar, për shkak të distancës. Në “Lulet e Jetës”, nga 18 fëmijë të identifikuar, 10 janë të regjistruar, pa ndonjë arsye përjashtuese të raportuar për pjesën tjetër.

Në aspektin e përfshirjes sociale:

- Kopshti Nr.1 përfshin 6 fëmijë romë/egjiptianë, të gjithë frekuentues të rregullt
- Të dy institucionet kanë fëmijë me nevoja të veçanta, që ndjekin procesin edukativ në mënyrë të përfshirë – 2 në Kopshtin Nr.1 dhe 1 në “Lulet e Jetës”
- Nuk raportohen fëmijë në situatë rruge apo që marrin ndihmë nga shërbimet sociale

Stafi dhe burimet njerëzore

Të dy institucionet kanë staf të angazhuar dhe aktiv në funksion të zhvillimit të fëmijëve. Kopshti Nr.1 ka 2 mësues, 1 mësues ndihmës dhe 1 drejtor, ndërsa “Lulet e Jetës” ka 6 mësues dhe 1 mësues ndihmës. Në aspektin ndihmës, “Lulet e Jetës” ka 4 punonjës ndihmës, por është identifikuar nevoja për një sanitare shtesë. Në të dy institucionet mungojnë psikologët dhe punonjësit socialë, dhe nuk janë organizuar trajnime për stafin mësimor dhe ndihmës në vitin aktual.

Strukturat menaxheriale

Të dy institucionet kanë struktura drejtuese dhe këshilluese funksionale:

- Bordi i Kopshtit është aktiv në planifikim dhe vendimmarrje për çështje materiale dhe financiare
- Këshilli i Prindërve tregon angazhim dhe bashkëpunim të lartë në çdo aspekt të funksionimit të kopshtit

Gjetje dhe rekomandime

Shërbimi i arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Roskovec karakterizohet nga një shtrirje e mirë territoriale në zonën urbane, një frekuentim i rregullt i fëmijëve, përfshirje e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe komunitetin. Institucionet përmbushin standardet bazë të **infrastrukturës, stafit dhe pajisjeve.**

Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë administrative Kurjan (Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Infrastruktura dhe aksesueshmëria

Në Njësinë Administrative Kurjan funksionojnë katër njësi të arsimit parashkollor të vendosura në fshatrat Kurjan, Vlosh, Ngjeqar dhe Mbërs. Të gjitha kopshtet janë të vendosura pranë shkollave 9-vjeçare ose qendrave komunitare dhe janë brenda zonave të banuara, duke garantuar akses për këmbësorët dhe automjetet. Rruga që të çon në secilin kopsht është e pajisur me trotuar, ndriçim rrugor dhe sinjalistikë. Transporti i fëmijëve është privat, për shkak të distancave të vogla në zonat rurale.

Kapaciteti dhe organizimi

Në total, gjatë vitit 2024–2025 janë regjistruar 46 fëmijë, të shpërndarë në 4 klasa, një për secilin fshat. Të gjithë kopshtet funksionojnë me grupe të përziera (mosha 3–6 vjeç), duke pasqyruar kontekstin rural dhe numrin e kufizuar të fëmijëve në secilin vendbanim.

Numri i fëmijëve të shpërndarë sipas moshës është:

- 3 vjeç: 15 fëmijë
- 4 vjeç: 14 fëmijë
- 5–6 vjeç: 17 fëmijë

Më së shumti fëmijë janë të regjistruar në Kurjan (18), ndërsa më pak në Mbërs (4). Për strukturën fizike, sipërfaqja e ambienteve të brendshme varion nga 28 m² (Ngjeqar) deri në 40 m² (Vlosh). Mobilimi përbëhet nga 8 tavolina dhe rreth 60 karrige, të shpërndara në katër klasa.

Pajisjet dhe kushtet sanitare

Të gjitha kopshtet përdorin tualetet dhe lavamanët e përbashkët me shkollat pritëse, për mungesë të infrastrukturës së dedikuar. Kopshti në fshatin Mbërs ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme, për shkak të problematikave në instalimet sanitare dhe mungesës së kushteve të përshtatshme (lyerje, suvatime, etj.).

Asnjë nga kopshtet nuk është i pajisur me dalje emergjente apo sistem alarmi sigurie, çka përbën një mangësi të rëndësishme për sigurinë e fëmijëve.

Shërbimet bazë


- Uji i pijshëm është i siguar përmes ujësjellësit publik dhe depozitave.
- Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti shtetëror.
- Ngrohja sigurohet me:
 - Kaldajë në Kurjan
 - Dru në Vlosh
 - Energji elektrike në Ngjeqar dhe Mbërs

Mungojnë lidhja telefonike dhe interneti, ndërkohë që janë të disponueshme letër higjienike, sapun dhe dezinfektues në të gjitha njësitë.

Mjete didaktike dhe ushqimi

Të katër kopshtet disponojnë mjete didaktike në nivel të kënaqshëm, të siguruar përmes bashkëpunimit mes prindërve, mësuesve dhe bashkisë. Megjithatë, për mbulimin e gjithë territorit të bashkisë, është evidentuar nevoja për mjete të reja për 400 fëmijë me një vlerë totale prej 500,000 lekësh.

Nuk ofrohet ushqim i gatuar në institucion, dhe nuk janë evidentuar raste të intolerancave ushqimore apo nevoja për pajisje të kuzhinës.



Frekuentimi dhe përfshirja

Të gjithë fëmijët (47) në moshë parashkollë që jetojnë në territorin e Njesisë Administrative Kurjan janë të regjistruar dhe frekuentojnë rregullisht kopshtin. Nuk ka fëmijë në situatë ruge, që marrin ndihmë sociale, që përkasin grupeve romë/egjiptianë, apo që kanë nevojë të veçanta. Kjo reflekton një mbulim të plotë të territorit dhe përfshirje sociale pa përjashtime.

Stafi dhe burimet njerëzore

Secili kopsht ka të angazhuar nga një mësues, duke përmbushur nevojën për 4 staf mësues gjithsej. Nuk ka staf ndihmës, psikologë apo punonjës socialë. Pastrimi i ambienteve realizohet nga sanitarët e shkollave përkatëse. Nuk janë zhvilluar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit mësues apo ndihmës.

Strukturat menaxheriale

Në të katër kopshtet janë të ngritura dhe funksionale:

- Bordi i Kopshtit, i cili merret me propozime për mbështetje financiare dhe diskutime të rregullta për nevojat e institucionit.
- Këshilli i Prindërve, që tregon bashkëpunim dhe reagim ndaj problematikave dhe iniciativave komunitare.

Gjetje dhe rekomandime

Arsimi parashkollor në Njësine Administrative Kurjan mbulohet nga një rrjet funksional prej katër kopshtesh që shtrihen në territorin rural të njesisë. Përfshirja e plotë e fëmijëve, stafi bazë i plotësuar dhe mbështetja nga komuniteti janë tregues pozitivë. Sfidat më të mëdha mbeten:

- Nevoja për rikonstrukcion në kopshtin Mbërs
- Mungesa e infrastrukturës së sigurisë (dalje emergjente, alarm)
- Mungesa e stafit ndihmës dhe trajnimeve profesionale

Këto elementë kërkojnë ndërhyrje të koordinuar institucionale, në mënyrë që të garantohet një cilësi më e lartë në ofrimin e shërbimit arsimor për fëmijët e kësaj njësie.

Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësine administrative Strum

(Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Infrastruktura dhe aksesueshmëria

Në Njësine Administrative Strum funksionojnë gjashtë njësi të arsimit parashkollor, të vendosura në fshatrat Strum, Velmish, Suk 1, Suk 2, Agacaj dhe Arapaj. Të gjitha kopshtet janë të pozicionuara në hapësira të përbashkëta me shkollat 9-vjeçare dhe përfitojnë nga infrastruktura ekzistuese e shkollës për funksionimin e përditshëm. Ato ndodhen brenda zonave të banuara dhe janë të aksesueshme për këmbësorë dhe automjete. Rrugët hyrëse janë të pajisura me trotuare, sinjalistikë dhe ndriçim rrugor, ndërsa transporti i fëmijëve është privat. Sipërfaqja e klasave varion nga 24 m² në Arapaj deri në 40 m² në Velmish, ndërkohë që çdo kopsht ka një ose dy klasa në varësi të numrit të fëmijëve dhe ndarjes sipas grupmoshës.

Kapaciteti dhe organizimi

Gjatë vitit akademik 2024–2025, numri total i fëmijëve të regjistruar në këto kopshte është 147, të shpërndarë në 10 grupe, duke përfshirë grupe të ndara (I, II, III) dhe grupe të përziera. Numri i fëmijëve është shpërndarë sipas grupmoshës si më poshtë:

- 3 vjeç: 39 fëmijë

- 4 vjeç: 47 fëmijë
- 5–6 vjeç: 61 fëmijë

Shumica e grupeve janë të organizuara sipas grupmoshave, përveç në Agacaj dhe Arapaj, ku për shkak të numrit më të vogël të fëmijëve ofrohet një klasë e vetme me grup të përzier. Në total janë në përdorim 30 tavolina dhe 173 karrige për të gjithë grupet, me një shpërndarje të përafërt sipas numrit të fëmijëve në secilin fshat.

Pajisjet dhe kushtet sanitare

Tualetet dhe lavamanët janë të përbashkët me ambientet shkollore, pasi nuk ka struktura të veçanta për kopshtet. Dy kopshte – në Arapaj dhe Agacaj – kanë nevojë të menjëhershme për rikonstruksion, duke përfshirë ndërhyrje sanitare, hidraulike, lyerje dhe suvatim.

Po në këto dy kopshte mungojnë dalje emergjente dhe sistem alarmi sigurie, duke i vendosur ato në një rrezik më të lartë përballë emergjencave apo incidenteve të mundshme.

Shërbimet bazë

Të gjitha njësitë e arsimit parashkollor në Strum janë të furnizuara me ujë të pijshëm përmes ujësjellësit publik ose depozitave dhe kanë furnizim të rregullt me energji elektrike nga rrjeti shtetëror.

Sistemet e ngrohjes ndryshojnë sipas vendndodhjes:

- Ngrohje me kaldajë në Velmish, Suk 1 dhe Suk 2
- Ngrohje elektrike në Strum, Agacaj dhe Arapaj

Në asnjë nga kopshte nuk ka linjë telefonike apo lidhje interneti. Ndërkohë, produktet bazë higjienike (letër, sapun, dezinfektues) janë të disponueshme në të gjitha klasat.

Mjete didaktike dhe ushqimi

Kopshtet në këtë njësi nuk janë të pajisura me mjete të mjaftueshme didaktike. Deri më sot, mjetet janë siguruar kryesisht nga prindërit, mësuesit dhe bashkia, por nevojitet një financim shtesë prej 250,000 lekësh për furnizim për 150 fëmijë. Kjo mbetet një ndër nevojat prioritare të raportuara.

Shërbimi i ushqimit nuk ofrohet në asnjë institucion, dhe aktualisht nuk ka raste të raportuara të intolerancave apo problemeve shëndetësore. Nuk janë planifikuar investime për kuzhina ose pajisje ushqimore.

Frekuentimi dhe përfshirja

Të gjithë 147 fëmijët në moshë parashkollore të identifikuar në territorin e Njësisë Administrative Strum janë të regjistruar dhe frekuentojnë rregullisht institucionet. Nuk ka fëmijë të paregjistruar, në situatë rruge apo që marrin asistencë sociale.

Gjithashtu, nuk ka fëmijë me përkatësi romë/egjiptianë apo me nevoja të veçanta të evidentuara. Kjo e bën këtë njësi model për mbulimin e plotë të edukimit në moshën e hershme.

Burimet njerëzore

Numri i mësuesve në dispozicion është 11, duke përmblusur plotësisht nevojat e raportuara për çdo klasë. Nuk ka staf ndihmës, psikologë apo punonjës socialë. Pastrimi i ambienteve sigurohet nga sanitarët e shkollave përkatëse, pasi kopshtet nuk kanë punonjës shërbimi të dedikuar.

Janë zhvilluar 3 trajnime për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve, por jo për stafin ndihmës apo mbështetës.

Strukturat menaxheriale

Në të gjitha kopshtet funksionon:

- Bordi i Kopshtit, i cili përfshihet në hartimin dhe miratimin e kontributeve për mbështetje materiale.
- Këshilli i Prindërve, që është aktiv dhe bashkëpunues në zgjidhjen e problematikave dhe organizimin e aktiviteteve.

Komisioni për Shëndetin, Sigurinë, Mirëmbajtjen dhe Mjedisin nuk është i ngritur në asnjë prej kopshteve.

Gjetje dhe rekomandime:

Shërbimi i arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Strum karakterizohet nga përfshirje e plotë e fëmijëve, organizim i qëndrueshëm dhe kapacitet i mbuluar mësimor. Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me infrastrukturën në Agacaj dhe Arapaj, mungesën e mjeteve didaktike, si dhe mungesën e burimeve njerëzore mbështetëse dhe strukturave të sigurisë. Një plan investimi dhe ndërhyrjeje e koordinuar do të ishte vendimtar për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimit.

Ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Kuman (Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Infrastruktura dhe aksesueshmëria

Në Njësinë Administrative Kuman funksionojnë disa njësi parashkollore të shpërndara në fshatrat Kuman, Luar, Vidhishtë, Marinëz dhe Jagodinë. Kopshtet janë të integruara kryesisht pranë godinave të shkollave 9-vjeçare, me përjashtim të kopshtit në Jagodinë, i cili ndodhet në qendër të fshatit, afër qendrës shëndetësore. Të gjitha objektet ndodhen brenda zonave të banuara dhe janë të aksesueshme për këmbësorë dhe automjete, me rrugë të pajisura me trotuare, ndriçim dhe sinjalistikë. Transporti për fëmijët është i organizuar në mënyrë private nga familjet.

Kapaciteti dhe organizimi

Kopshtet e kësaj njësie funksionojnë me hapësira të kufizuara, zakonisht një klasë për çdo institucion, me sipërfaqe mesatare 30 m² për klasë (25 m² në Jagodinë). Në total, janë të regjistruar 83 fëmijë, të ndarë në 6 grupe të përziera, që përfshijnë moshat 3 deri në 6 vjeç.

Shpërndarja sipas grupmoshave:

- 3 vjeç: 30 fëmijë
- 4 vjeç: 25 fëmijë
- 5–6 vjeç: 28 fëmijë

Përbërja gjinore sipas kopshteve:

- Kuman: 18 fëmijë (6 vajza / 12 djem)
- Marinëz: 17 fëmijë (6 vajza / 11 djem)
- Luar: 12 fëmijë (6 vajza / 6 djem)
- Jagodinë: 18 fëmijë (6 vajza / 12 djem)
 - Vidhishtë 14 fëmijë (7 vajza / 7 djem)



Në total janë 78 fëmijë të ndarë në 10 klasa, me 83 karrige dhe 23 tavolina në dispozicion. Tualetet dhe lavamanët janë të përbashkët me shkollat përkatëse, duke treguar mungesë të infrastrukturës së dedikuar për kopshtet.

Gjendja e ndërtesave dhe siguria

Pjesa më e madhe e godinave është funksionale, por në kopshtin Jagodinë nevojitet ndërhyrje infrastrukturore dhe sanitare, përfshirë lysterje dhe suvatime. Në asnjë prej objekteve nuk ka dalje emergjente (përveç kopshtit në fshatin Kuman,,godina e shkollës ka dalje) apo sistem alarmi, çka përbën një mangësi serioze në aspektin e sigurisë fizike për fëmijët dhe stafin.

Shërbimet bazë dhe ngrohja

Uji i pijshëm sigurohet përmes ujësjellësit publik ose depozitave. Ngruhja realizohet me lloje të ndryshme sistemesh, sipas vendndodhjes:

- Marinëz: kaldajë
- Vidhishtë,Kuman,Jagodinë dhe Luar : energji elektrike

Të gjitha institucionet janë të lidhura me rrjetin shtetëror të energjisë, por mungojnë lidhjet telefonike dhe interneti. Produktet higjienike bazë janë të siguruara.

Mjete didaktike dhe ushqimi

Kopshtet janë të pajisura me mjete didaktike të mjaftueshme, të siguruara nga bashkëpunimi ndërmjet prindërve, stafit dhe bashkisë. Megjithatë, për përmirësimin e mëtejshëm, është kërkuar një financim prej 500.000 lekësh për gjithë arsimin parashkollor në bashki. Asnjëri prej kopshteve nuk ofron shërbim ushqimor, nuk disponon pajisje kuzhine dhe nuk janë raportuar raste me intoleranca ushqimore apo probleme shëndetësore.

Frekuentimi dhe përfshirja

Frekuentimi i fëmijëve është i rregullt në të gjitha institucionet dhe nuk janë raportuar mungesa të larta. Të gjithë 78 fëmijët në moshë parashkollore të identifikuar janë të regjistruar dhe frekuentojnë kopshtin. Nuk ka fëmijë në situatë rruge, romë apo egjiptianë, apo që marrin asistencë sociale. Gjithashtu nuk janë evidentuar fëmijë me nevojë të veçanta.

Burimet njerëzore

Stafi mësimor është i plotësuar me 7 mësues (nga një në Jagodinë,Luar,Marinëz dhe 2 në Vidhishtë dhe Kuman). Nuk ka staf ndihmës të dedikuar për kopshtet; pastrimi i ambienteve mbulohet nga sanitarët e shkollave ku ndodhen kopshtet. Po ashtu mungojnë psikologë dhe punonjës socialë, ndërkohë që nuk janë zhvilluar trajnime për rritjen e kapaciteteve për asnjë kategori stafi.

Strukturat menaxheriale

Të gjithë kopshtet kanë funksional Bordin e Kopshtit dhe Këshillin e Prindërve, të cilët angazhohen në vendimmarrje për nevojë materiale dhe organizimin e aktiviteteve. Komisioni për Shëndetin, Sigurinë, Mirëmbajtjen dhe Mjedisin nuk është funksional, duke paraqitur një boshllëk në monitorimin cilësor të kushteve të sigurisë dhe mjedisit.

Gjetje dhe rekomandime:

Njësia Administrative Kuman ofron një shërbim funksional parashkollor, me mbulim të plotë të fëmijëve dhe angazhim të stafit, por përballen me sfida të konsiderueshme në infrastrukturë, siguri dhe mbështetje sociale. Zgjidhja e këtyre problematikave do të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e edukimit dhe në mirëqenien e fëmijëve.

Të dhënat për burimet financiare për shërbimin e arsimit parashkollor – Kopshtet 2023 - 2025

Viti	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (lekë)	Transferimet nga qeveria qendrore (lekë)	Pesha në të ardhurat totale (%)
2023	1,756,392		0.69%
2024	2,260,547		0.84%
Prill 2025	537,795		1.23%
Transferimet		45,794,683	

Prioritetet strategjike për arsimin parashkollor

Prioritetet për periudhën 2026–2028:

1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies.
2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i edukatoreve dhe stafit ndihmës.
3. Përfshirja aktive e familjes në procesin edukativ (takime me prindër, këshilla të prindërve etj.).
4. Përmirësimi i infrastrukturës:
 - o Rinovimi i ambienteve ekzistuese
 - o Pajisja me materiale bashkëkohore
 - o Shtimi i kapacitetit për kopshtin me drekë dhe çerdhes.
5. Sigurimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes për të gjithë fëmijët, përfshirë me aftësi të kufizuara dhe nga komunitete në nevojë.
6. Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies emocionale të fëmijëve.
7. Zgjerimi i kapaciteteve për kopshtet dhe çerdhet.

Burimet financiare të disponueshme

Viti	Transferta e pakushtëzuar	Të ardhurat vendore
2026	45,794,683 lekë	2,000,000 lekë
2027	45,794,683 lekë	2,000,000 lekë
2028	45,794,683 lekë	2,000,000 lekë

Nevojat prioritare për investime (2026–2028)

- Kthimi i kopshtit Nr.1 në kopsht me ushqim
- Kopsht i përqendruar në Njësinë Administrative Strum

3. Analiza e shërbimit në shkolla

Njësia Administrative: Roskovec

(Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Në total, funksionojnë 3 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 është shkollë 9-vjeçare që ofron ciklin bazë të arsimit, dhe 2 janë shkolla të mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.



Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
"Goja e Arte"
"Ademi Vrapit"
"Alush Grepcka"

Gjendja Infrastrukturore dhe nevojat për investim


- Shkolla "Adem Vrapit" ka një ndërtesë 3-katëshe në gjendje të mirë, por kërkon lysterje të ambienteve të brendshme, si dhe riparime të pjesshme në laboratorë, pajisje të dëmtuara dhe sistem ndriçimi.
- Shkolla "Alush Grepcka" ka një hapësirë të madhe shkollore dhe oborr funksional, por kërkon rikonstrukcion të rrethimit të jashtëm, vendosjen e një sistemi sigurie me kamera dhe riparim të mobilieve ekzistuese.

Nevojat prioritare për investim përfshijnë:

- Përmirësimin e sigurisë shkollore
- Modernizimin e ambienteve të brendshme
- Rregullimin e pajisjeve mësimore dhe mobilieve

Shërbimet themelore dhe higjiena

- Të dyja shkollat kanë furnizim me ujë të pijshëm nga ujësjellësi publik.
- Të dy institucionet kanë ngrohje funksionale:
 - "Adem Vrapit" me kaldajë
 - "Alush Grepcka" me kaldajë me naftë
- Aksesit në internet është i disponueshëm në të dyja, por mungon sistemi i alarmit në të dy institucionet.
- Tualetet, lavamanët dhe higjiena janë të garantuara në masë të madhe.



Mungesa e sistemit të alarmit dhe monitorimit është një boshllëk i qartë në sigurinë e infrastrukturës.

Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike

Shkolla	Nxënës	Klasat	Djem / Vajza
<i>Adem Vrapit</i>	325	12	150 M / 175 F
<i>Alush Grepcka</i>	396	23	2280/ 168 F

- “Alush Grepcka” është shkolla më e madhe në bashki për sa i përket numrit të nxënësve.
- Të dyja shkollat kanë strukturë të plotë klasash dhe janë funksionale në mënyrë të qëndrueshme.

Transporti i nxënësve

- Në “Adem Vrapit” nxënësit e sigurojnë vetë transportin, pasi arsimi i mesëm nuk është i detyrueshëm.
- Në “Alush Grepcka”, 20 nxënës kanë nevojë për transport dhe vetëm 15 prej tyre e përfitojnë.

Përfshirja sociale dhe mbështetja psiko-sociale

- Shkolla “Alush Grepcka” shfaq një profil të qartë përfshirjeje sociale:
 - 23 fëmijë romë/egjiptianë (22 ndjekin shkollën)
 - 10 fëmijë me ndihmë ekonomike
 - 3 fëmijë me nevojë të veçanta
- Shërbimi psikologjik është i disponueshëm vetëm në “Adem Vrapit”, ndërsa mungon shërbimi social në të dyja shkollat.

Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale

- “Adem Vrapit” ka staf të plotë ndihmës: 6 punonjës (roje, sanitare, oficer sigurie)
- “Alush Grepcka” ka 5 punonjës ndihmës
- Të dyja shkollat kanë borde funksionale të shkollës, që përfaqësojnë organizim të mirë institucional dhe ndihmojnë në menaxhimin e nevojave.

Gjetje dhe rekomandime

1. ☒ Shkollat në Roskovec kanë infrastrukturë të qëndrueshme dhe kapacitete të larta për të ofruar arsim cilësor.
2. ☐ Siguria në shkolla mbetet e paplotë, për shkak të mungesës së sistemeve të alarmit dhe kamerave.
3. ☐ Transporti i nxënësve është i pjesshëm, veçanërisht për shkollën 9-vjeçare, dhe kërkon përmirësim.

Njësia Administrative: Kuman

(Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Në territorin e njësise funksionojnë gjithsej 4 shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë, të shpërndara në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal.

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
“Rexhep Kothere – Kuman”

"Ali Sollaku"-Vidhishtë
"Jorgo Sopiku" -Luar
"Naun Doko" - Marinëz

Gjendja linfrasturkturore dhe nevojat për Investim

- Të gjitha shkollat raportojnë nevoja për rikonstruksion, veçanërisht:
 - "Ali Sollaku" ka nevojë për rikonstruksion të plotë.
 - "Naun Doko" dhe "Jorgo Sopiku" kërkojnë ndërhyrje në sistemet sanitare, elektrike dhe izolim.
 - "Rexhep Kothere" ka mungesa të specifikuar, por raportohen probleme me dyer, dritare, tualete dhe mobilim.
- Mungojnë daljet emergjente (përvec shkollës "Rexhep Kothere") dhe sistemet e alarmit në të gjitha shkollat.

Shërbimet themelore dhe higjiena

- Uji i pijshëm mungon në dy shkolla: "Ali Sollaku" dhe "Rexhep Kothere".
- Në disa shkolla mungojnë lavamanët ose janë në numër të pamjaftueshëm.
- Ngrohja është e disponueshme, por me sisteme të ndryshme (kaldajë, elektrik, dru).

Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike

Shkolla	Nxënës	Klasat
"Ali Sollaku"	82	12
"Naun Doko"	99	21
"Jorgo Sopiku"	78	11
"Rexhep Kothere"	96	9

- Shkollat janë aktive dhe me shpërndarje të mirë të klasave, por me mungesë pajisjesh (karrige, tavolina) dhe nevojë për riparime të mobilie.

Transporti i nxënësve

- Në asnjë shkollë nuk ofrohet transport, megjithëse:
 - "Naun Doko": 27 nxënës me nevojë
 - "Jorgo Sopiku": 25 nxënës
 - "Rexhep Kothere": 10 nxënës

Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale

- Çdo shkollë ka nga 2 punonjës ndihmës, por disa raportojnë nevojë për staf shtesë.
- Të katër shkollat kanë borde funksionale, gjë që tregon organizim institucional minimalisht të rregullt.

Gjetje dhe rekomandime

1. 🏠 Gjendja linfrasturkturore kërkon ndërhyrje urgjente në të katër shkollat.
2. 🚨 Mungesa e sigurisë (dalje emergjente, alarm) përbën një rrezik të vazhdueshëm për nxënësit.
3. 🚌 Transporti është një boshllëk kritik, duke ndikuar negativisht në frekuentimin e shkollës, veçanërisht për fëmijët që jetojnë në zona të thella.
4. 👶 Fëmijët në nevojë (sociale ose me aftësi ndryshe) janë të pranishëm, por mungojnë plotësisht shërbimet mbështetëse.
5. 🏢 Strukturat menaxheriale janë funksionale, por kërkojnë mbështetje me staf, pajisje dhe përfshirje të komunitetit.

Njësia Administrative: Kurjan (Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Në njësinë administrative Kurjan funksionojnë 3 shkolla, të shpërndara në territor në mënyrë që të përmbushin nevojat arsimore të komunitetit lokal. Prej tyre, 2 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë arsimin bazë, ndërsa 1 është shkollë e mesme dhe shkollë 9-vjeçare, e cila u mundëson të rinjve të ndjekin arsimin e lartë ose të përgatiten për hyrjen në tregun e punës.

Ky numër institucionesh arsimore garanton një mbulim të gjerë të territorit, duke krijuar kushte për përfshirje të barabartë dhe akses të vazhdueshëm në arsim për të gjithë fëmijët e zones, si në qendrat e banuara me më shumë dendësi, ashtu edhe në zonat rurale dhe periferike. Përmes këtij organizimi, kontribuohet drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe në rritjen graduale të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
“Sabri Refiti” Ngjeqar
“Jashar Muhameti “, Vlosh
“Didin Bishani” Kurjan

Gjendja Infrastrukturore dhe nevojat për investime


- Dy nga tre shkollat (“Jashar Muhameti” dhe “Sabri Refiti”) kanë nevojë për rikonstrukcion sanitar ose lysterje.
- Vetëm “Didin Bishani” nuk kërkon rikonstrukcion, por ka nevojë për dalje emergjente.

Shërbimet themelore dhe higjiena

- Në dy shkolla nuk ka mungesë të furnizimi me ujë të pijshëm.
- Sistemet e alarmit dhe sigurisë janë kryesisht të munguar, me përjashtim të “Didin Bishani” që ka alarm, por jo dalje emergjente.

Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike

- Të tre shkollat kanë strukturë të gjerë klasash: 12–16 klasa secila.
- Shkolla “Sabri Refiti” ka numër shumë të vogël nxënësish (44) për 16 klasa – ndoshta sinjal i braktisjes ose i organizimit joefikas.



- “Didin Bishani” është shkolla më gjithëpërfshirëse, që ofron arsim 9-vjeçar, kopsht dhe të mesëm.

Transporti i nxënësve

- Në asnjë shkollë nuk ofrohet transport publik, edhe pse ka dhjetëra nxënës në nevojë:
 - 100 në “Didin Bishani”
 - 20 në “Sabri Refiti”
- Kjo përbën një barrë serioze për familjet dhe një faktor risku për braktisjen e shkollës.

Përfshirja sociale dhe barazia në arsim

- Vetëm një shkollë (“Sabri Refiti”) ka raportuar 8 fëmijë që marrin ndihmë sociale.
- Të dhënat për fëmijët romë, me nevoja të veçanta apo në situatë rruge mungojnë për shumicën e shkollave – kjo tregon mangësi në identifikim dhe raportim.

Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale

- Shkollat kanë nevoja të pjesshme për staf ndihmës, por mungojnë të dhëna të plota për “Jashar Muhameti”.
- Shërbimi psikologjik dhe social ofrohet vetëm në “Sabri Refiti” dhe “Didin Bishani” – mungon në “Jashar Muhameti”.
- Të tria shkollat kanë borde funksionale, çka është një pikë pozitive për menaxhimin e institucionit.

Gjetje dhe rekomandime

- 🏠 Shkollat në Njësinë Administrative Kurjan përballen me sfida të kombinuara infrastrukturore dhe sociale.
- 🚗 Mungesa e transportit dhe e ujit të pijshëm, së bashku me nivelin e ulët të raportimit social, rrezikojnë aksesin dhe cilësinë në arsim, veçanërisht për fëmijët në nevojë.
- 👤👤 Shkolla “Didin Bishani” paraqitet si qendra arsimore më e konsoliduar, ndërsa “Jashar Muhameti” dhe “Sabri Refiti” kanë nevojë për ndërhyrje prioritare për rikonstruksion, furnizim higjienik dhe mbështetje sociale.

Njësia Administrative: Strum

(Të dhënat për vitin shkollor 2024–2025)

Në njësinë administrative Strum funksionojnë 6 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 2 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 4 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit.





Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
Shkolla e Ciklit të Ulët Arapaj
Shkolla e Ciklit të Ulët Agacaj
“7 Dëshmorët”
“5 Dëshmorët”
“Zylyftar Veleshnja”
“Ajet Toska”

Gjendja infrastrukturore dhe nevojat për investim

- 4 nga 6 shkollat kanë nevojë për rikonstruksion, kryesisht për instalime sanitare, lysterje, izolim tarrace dhe sistem ndriçimi.
- “CU Arapaj” dhe “CU Agaçaj” kërkojnë rikonstruksion të plotë.
- Mungesa e daljeve emergjente dhe sistemeve të alarmit është e zakonshme në shumicën e shkollave.

Shërbimet themelore dhe higjiena

- Higjiena është e pamjaftueshme në shkollat më të vogla, ku mungojnë lavamanët, letër higjienike, dhe dezinfektuesit.
- Shumica e shkollave kanë ngrohje të thjeshtë ose me naftë, por nuk raportojnë probleme me furnizimin me energji elektrike.

Kapaciteti nxënës dhe profilet demografike

- Shkollat përfshijnë një gamë të gjerë: nga 37 nxënës (CU Arapaj) deri në 167 nxënës (“5 Dëshmorët”).
- “7 Dëshmorët” dhe “Ajet Toska” kanë infrastrukturë më të mirë dhe shërbejnë një numër të konsiderueshëm nxënësish.
- Shkollat e vogla (CU-të) kanë kapacitet të kufizuar dhe shërbime minimale.

Transporti i nxënësve

- Asnjë nga shkollat nuk ofron transport publik, edhe pse:
 - “5 Dëshmorët” ka 80 nxënës me nevojë për transport,
 - “Zylyftar Veleshnja”, “Ajet Toska”, dhe të tjera kanë fëmijë që jetojnë më shumë se 100–150 m larg.

- Mungesa e transportit përbën pengesë të drejtpërdrejtë për aksesin në arsim dhe rrit riskun e braktisjes shkollore.

Përfshirja sociale dhe mbështetja psiko-sociale


- Vetëm “7 Dëshmorët” raporton për fëmijë me nevoja të veçanta (2) dhe me ndihmë sociale (12).
- Shkollat e tjera raportojnë raste të kufizuara ose nuk kanë evidentuar të dhëna mbi fëmijë romë/egjiptianë, me nevoja të veçanta apo që marrin asistencë sociale.
- Nuk ka shërbim psikologjik apo social në shumicën e shkollave – përjashtim bën vetëm “7 Dëshmorët”.

Burimet njerëzore dhe strukturat menaxheriale

- Shumica e shkollave kanë 1–2 punonjës ndihmës, por në disa raste numri është i pamjaftueshëm.
- Vetëm 4 nga 6 shkollat kanë borde funksionale të shkollës – dy CU-të (“Arapaj” dhe “Agaçaj”) nuk kanë struktura menaxheriale aktive.

Gjetje dhe rekomandime

1. 🏠 Shkollat në Njësinë Administrative Strum përballen me sfida të theksuara infrastrukturore, higjienike dhe të sigurisë – sidomos në shkollat e vogla .
2. 🚫 Mungesa e transportit publik për nxënësit është një faktor rreziku për përjashtim arsimor.
3. 🏫 Dallim i madh midis shkollave qendrore dhe shkollave të ciklit të ulët periferike.



4. Prioritetet strategjike të bashkisë për Arsimin (Shkollat)

Prioritetet për periudhën 2026–2028:


1. Sigurimi i ambienteve shkollore të sigurta (vendosja e sistemeve të ngrohjes, rikonstruksione dhe ndërhyrje sipas nevojës).
2. Përmirësimi i kushteve higjeno-sanitare në shkolla.
3. Zhvillimi dhe funksionalizimi i hapësirave të jashtme sportive.

5. Nevojat prioritare për investime në shkolla (2026–2028)

1. Rikonstruksion i objektit ekzistues të shkollës 9-vjeçare "Ali Sollaku", Vidhisht – përfshirë ambientet sportive, ndërtimin e shkallëve të emergjencës dhe godinën e re të palestrës.
2. Rikonstruksione të pjesshme në godinat ku janë të nevojshme.

6. Vizioni dhe objektivat strategjike

“Të garantojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe cilësor për çdo fëmijë në Roskovec, përmes investimeve të qëndrueshme në infrastrukturë, zhvillimit profesional të stafit, digjitalizimit të mësimdhënies dhe fuqizimit të rolit të komunitetit shkollore.”



Qëllimi 1 (Q1)

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe modernizimi i infrastrukturës arsimore

– Të garantohet një mjedis i sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës për çdo institucion arsimor përmes mirëmbajtjes sistematike dhe investimeve të orientuara drejt standardeve bashkëkohore.

Qëllimi 2 (Q2)

Rritja cilësore dhe mirëqenia gjithëpërfshirëse e fëmijëve

– Të sigurohet zhvillimi i plotë emocional, social dhe kognitiv i çdo fëmije, përmes shërbimeve edukative të personalizuar, mbështetjes psiko-sociale dhe përkujdesjes së integruar.

Qëllimi 3 (Q3)

Nxitja e pjesëmarrjes aktive dhe formimit qytetar të fëmijëve

– Të promovohet zhvillimi i talenteve dhe aftësive të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që forcojnë shëndetin, krijimtarinë, bashkëpunimin dhe ndjenjën e përkatësisë në komunitet.



7. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteve)


Qëllimi 1 (Q1) – Të garantohet një mjedis i sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës për çdo institucion arsimor përmes mirëmbajtjes sistematike dhe investimeve të orientuara drejt standardeve bashkëkohore.

Objekti i specifik O1.1 Të sigurohen shërbimet bazë dhe mirembajtja e vazhdueshme e infrastrukturës arsimore

Aktivitet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastrukturës arsimore	2026–2028	Drejtoria e Infrastrukturës	Shkollat, Qendrat komunitare	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Nr. ndëhyrjeve të realizuara në godina
Garantimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve higjieno-sanitare	2026–2028	Drejtoria e Arsimit	Shkollat, operatorë të higjienës	Buxhet vendor	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2026–2028	Drejtoria e Infrastrukturës	Operatorë të energjisë, MASR	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve me sistem funksional ngrohjeje
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore	2026–2028	Zyra Arsimore	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fiksve të zjarrit	2026–2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fiksve të vendosura dhe funksionale
Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore	2026–2028	Zyra Arsimore	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion

Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore	2026-2028	Zyra Arsimore	Shkollat, MASR	Buxhet vendor + donacione	Nr. i institucioneve të pajisura me mjete didaktike
Furnizimi dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor	2026-2028	Zyra Shëndetit Publik & Arsimit	Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor	Nr. i mensave funksionale në kopshte
Ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve të domosdoshme mbështetëse për funksionimin e institucioneve arsimore	2026-2028	Drejtoria e Arsimit	NJA, staf teknik	Buxhet vendor	Nr. i njëjësive me staf dhe pajisje të nevojshme
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2026-2028	Drejtoria e Shëndetësisë & Arsimit	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit

Objekti specifik: O1.2 Përmirësimi i infrastrukturës arsimore, përmes rikonstruksionit të kopshteve dhe institucioneve arsimore, pajisjes me mobilie si dhe ngritjes së një sistemi elektronik për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të institucioneve arsimore.					
Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Përgjegjësi	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Rikonstruksion i shkollës 'Ali Sollaku', përmirësim i infrastrukturës sanitare, ngrohje dhe furnizim me ujë/energji	2026-2028	Drejtoria e Arsimit	Qeveria shqiptare, bashkisë, komuniteti, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i shkollave të rikonstruktura; përmirësim i kushteve



Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për arsimin parashkollor kopshet në kuadër të planit për përmirësim të arsimit parauniversitar.	2026-2028	Drejtoria e Arsimit dhe IT	Kopshet/shkollat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë)	Një regjistër i shërbimit për arsimin parashkollor, I krijuar, dhe I përditësuar çdo vit
	2026-2028	Drejtoria e Infrastrukturës	Zyra Urbanistikës, komuniteti	Buxheti vendor + donacione	Nr. i kopshteve dhe çerdheve të reja; ndarje funksionale


Qëllimi 2 (Q2) – Të sigurohet zhvillimi i plotë emocional, social dhe kognitiv i çdo fëmije, përmes shërbimeve edukative të personalizuar, mbështetjes psiko-sociale dhe përkujdesjes së integruar.

Objekti i specifik O2.1 Të rritet cilësia e shërbimeve edukative për fëmijët parashkollorë

Aktivitet	Përiudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Pajisje me materiale didaktike, kompjuterë dhe trajnime për edukatorët	Çdo vit	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MAS, partnerë zhvillimi	Buxhet vendor, partnerë	Nr. i fëmijëve që përfitojnë nga mjetet dhe trajnimet

Objektivi specifik O2.2 Të forcohet përkujdesja sociale për fëmijët në nevojë

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte	2026-2028	Drejtoria e Arsimit dhe Burimeve Njerëzore	OJQ sociale, MAS	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve me ndihmë sociale;
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.	2026-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin	Administratorët e Njësive Administrative; Këshilli bashkiak; Kopshtet; Prindëri	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla active
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte	2026-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore; Njësia përgjegjëse për Kopshtet; OSHC Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) Nr. i fëmijëve (vajza/djem;	Kopshtet; OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)0	




			nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social shërbimet sociale	
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2026–2028	Zyra e Shërbimeve Sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale 2026–2028
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera	2026–2028	Drejtoria e Arsimit	MASR, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shpërblime nga MASR 2026–2028

Qëllimi 3 (Q3)– Të promovohet zhvillimi i talenteve dhe aftësive të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që forcojnë shëndetin, krijimtartinë, bashkëpunimin dhe ndjenjën e përkatësisë në komunitet.

Objektivi specifik O3.1 Të nxitet zhvillimi gjithëpërfshirës përmes veprimtarive jashtëmësimore

Aktivitet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale:	Çdo vit	Qendrat Kulturore / Shkollat	Prindër, OJQ, MASR	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirëse
• 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit • Prill–Maj – Java Olimpikë • 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve • 21 Nëntor – Dita e Luftës Kundër Bullizmit					

• 2026 – Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe • 3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Afësi të Kufizuara • 22 Mars – Dita Botërore e Ujit (UNESCO) • 23 Prill – Dita Botërore e Librit • 5 Qershor – Dita Botërore e Mjedisit				
--	--	--	--	--



8. Buxheti i planifikuar për Arsimin (2026–2028)

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore. Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar ngarkesën buxhetore të bashkisë, mënyrën e përdorimit të fondeve publike për arsimin, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit

Shërbimi i arsimit parashkollor financohet nëpërmjet dy burimeve kryesore të të ardhurave: të ardhurat vendore nga taksat dhe tarifat, si dhe transferimet nga qeveria qendrore.

- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për arsimin parauniversitar përbëjnë një komponent të rëndësishëm të buxhetit, duke reflektuar angazhimin e bashkisë për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare për shërbimet vendore që ka kompetencë.
- Transferimet e pakushtëzuara sektoriale nga qeveria qendrore mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin e institucioneve arsimore, duke përfshirë pagat e stafit dhe shpenzimet operative.

Burimet financiare të disponueshme

Spektori	2026 (mijë lekë)	2027 (mijë lekë)	2028 (mijë lekë)
Arsimi parauniversitar			
Arsimi 9-vjeçar			
Arsimi i mesëm			

Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parashkollor është 258035 mijë lekë, të shpërndara si më poshtë:

Viti 2025

Totali i planifikuar për vitin 2025 është 55,199, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2025 (mijë lekë)
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	47,589
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	7,610
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	

Viti 2026

Totali i planifikuar për vitin 2026 është 55,199, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2026 (mijë lekë)
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	47,589
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	7610
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	

Viti 2027

Totali i planifikuar për vitin 2027 është 55,199 ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2027(mijë lekë)
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	47,589
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	7,610
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	

Viti 2028

Totali i planifikuar për vitin 2028 është 0 ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2028(mijë lekë)
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	47,589
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	7610
602	Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime	
231	Shpenzime per rritjen a aktiveve te qendrueshme te trupezuara	


Shërbimet operative dhe mirëmbajtja Arsimit parashkollor

Shërbimi / Artikulli	2026 (lekë)	2027 (lekë)	2028 (lekë)
Shpenzime për mirëmbajtje dhe pastrim	1500	1500	1500
Materiale didaktike për arsimin parashkollor	300	350	500
Kompjuter, printer, letër A4 / bojë printeri	100	100	100
Energji	700	700	700
Ujë i pijshëm	500	500	500
Shpenzime për ushqime (kopsht + çerdhe)	3,000	3,000	3,000
Gaz për gatim (kopsht + çerdhe)	200	200	200
Materiale elektrike, hidraulike	500	500	500
Enë kuzhine (kopsht + çerdhe)	250	250	250
Internet	40	40	40

Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parauniversitar(shkollat) është 8742 mijë lekë, të shpërndara si më poshtë:

Viti 2025

Totali i planifikuar për vitin 2025 është 2,994 ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:



Kodi i llogarise	Llogaria	2025
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	2,583
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	411

Viti 2026

Totali i planifikuar për vitin 2026 është 2,994 ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2026
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	2,583
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	411

Viti 2027

Totali i planifikuar për vitin 2027 është 2,994 ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2027
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	2,542
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	411


Viti 2028

Totali i planifikuar për vitin 2028 është 2,994,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Kodi i llogarise	Llogaria	2028
600	Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	2583
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	411


Shpenzimet operative për arsimin – shkollat (2026–2028)

Viti	Përshkrimi	2025 (lekë)	2026 (lekë)	2027 (lekë)	2028 (lekë)
	Lëndë djegëse (dru/pelet)	500	500	500	500
	Detergjentë	800	800	800	800
	Naftë për kaldaja	1,300	1,300	1,300	1,300
	Ujë i pijshëm	2,200	2,200	2,200	2,200
	Energji elektrike	3,000	3,000	3,000	3,000
	Mirëmbajtje të ndryshme	1000	1000	1000	1000



9. Plani i investimeve kapitale

Emërtimi i Projektit	Buxheti në mijë lekë 2026	Buxheti në mijë lekë 2027	Buxheti në mijë lekë 2028
Rikonstrukcion i shkollës 'Ali Sollaku' dhe ndërtim palestres	-	-	-
Kthimi në kopsht me ushqim I Kopshtit Nr1, Roskovec	-	-	-



10. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjike. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktiviteteve në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore.

Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

1. Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.



Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbliken në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pikë të realizuara / Pikë maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

2. Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet 0.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

11. Rishikimi dhe përshtatja e planit


Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Roskovec. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i Rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra.

Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;



- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Roskovec.

12. Raportimi dhe transparencia

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.



13. Aneke:

Kuadri Ligjor dhe Nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 1
- Ligji Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018
- Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji Nr. 9936/2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025
- Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore



MIRATOI

KRYETAR
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Goga

